

KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër:	Adresa postare: Elbasan,3001	Data: 18/07/2023
---------------	------------------------------	------------------

Autoriteti Publik : AKPA
Adresa: Rruga Rifat Bodinaku
Qyteti: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

1. A ka zbatuar AKPA ndonjë masë për të siguruar që përdoruesit me aftësi të kufizuara fizike të kenë akses dhe të përdorin shërbimet e tyre online në mënyrë efektive?

Aktualisht AKPA ka në funksion webfaqen zyrtare dhe portalin online të punësimit puna.gov.al me qëllim adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara në qasjen e shërbimeve të dedikuara ndaj tyre.

Platforma puna.gov.al është një platformë funksionale dhe ofron për të gjithë informacionin e nevojshëm për shërbimet dhe programet e punësimit dhe të aftësive të nevojshme për integrimin e punëkërkuësve në tregun e punës. [Puna.gov.al](http://puna.gov.al) ofron jo vetëm informacion por ndërveprim të integruar me punëdhënësit drejtpërdrejt duke siguruar që punëkërkuësit me aftësi të kufizuara fizike të kenë mundësinë për të aplikuar për vende të lira punë online, duke e bërë më të lehtë procesin e aplikimit.

Gjithashtu, AKPA është duke punuar për përmirësimin e shërbimeve online dhe ndërveprimin me personat me aftësi të kufizuara që nga momneti i rregjistrimit si punëkërkuës i papunë, deri te referimi për një program apo vend pune të përshtatshëm për ta.

2. Cilat burime ose mjete janë të disponueshme brenda shërbimeve online të AKPA për të ndihmuar përdoruesit me njohuri të kufizuara teknologjike? 3. A ofron AKPA ndonjë trajnim ose mbështetje për përdoruesit që mund të mos kenë aftësitë e nevojshme teknologjike për të përdorur shërbimet online të e-Albania? 4. A ka ndonjë guidë ose manual të disponueshëm për të ndihmuar përdoruesit të aksesojnë në mënyrë efektive shërbimet online?

Në kuadër të objektivit të Strategjive Kombëtare për rritjen e aftësive digjitale, AKPA ka hartuar kurrikulën e aftësive digjitale në bazë të kërkesave të EU Digicom Skills, e cila parashikon 5 grupe kompetencash që qytetari duhet të zotërojë në përfundim të kursit. Në këtë kurrikul, të gjithë punëkërkuësit marrin informacion gjithashtu edhe për përdorimin e shërbimeve të punësimit dhe mënyrës së përdorimit të puna.gov.al. Agjencia aktualisht po e piloton këtë kurrikul duke synuar trajnimin e mbi 3000 punëkërkuësve lidhur me këto aftësi.

5. A ka krijuar AKPA zyra të asistencës fizike apo qendra mbështetëse posaçërisht për qytetarët me aftësi të kufizuara fizike ose njohuri të kufizuara digjitale?

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, me qëllim sigurimin e aksesimit nga të gjithë të shërbimeve të punësimit ka pajisur Zyrat e Punës me infrastrukturë të përshtatur (rampë) për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, në vitin 2022 AKPA ka realizuar rikonstruksiion e plotë të Zyrës së Punësimit Tiranë pranë Vasil Shanto, e dedikuar për ofrimin e shërbimeve të punësimit në zonën 2. Kjo zyrë do të shërbejë si model për tu përshtatur me qëllim gjithëpërfshirjen në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht të kategorive PAK. Zyra e Punësimit nr. 2 në Tiranë ofron shërbimet të përshtatura:

- Për personat me kufizim dhe aksesorëve si mouse ergonomik për të lehtësuar aksesueshmërinë e shërbimeve;
- Për individët që nuk flasin dhe nuk degjojnë, mundësohet realizimi i takimeve virtuale me një interpretër të gjuhës së shenjave, si dhe vendosjen e ekraneve, të cilët transmetojnë video informuese në gjuhën e shenjave;
- Për personat me kufizim në shikim përmes investimi në pajisjen me Daisy Reader, me ane të së cilës dëgjohen mesazhet zanore, si edhe kompjutera të konfiguruar me sistemin JAËS i cili bën të mundur aksesin në internet dhe çdo program tjetër.

Përmes këtij investimi bëhet i mundur aksesin më i madh i këtij grupi në shërbimet e punësimit të targetuara dhe përshtatura, orientimi për kurset e formimit profesional me qëllim integrimin më të shpejtë në tregun e punës.

6. Çfarë hapash ka ndërmarrë AKPA për të adresuar çdo problem apo sfidë me të cilën përballen përdoruesit me aftësi të kufizuara fizike ose njohuri të kufizuara teknologjike në përdorimin e shërbimeve online?

Aktualisht, AKPA ka nisur punën për përmirësimin e portalit kombëtar të punësimit puna.gov.al, me qëllim pasurimin e tij me elementët e nevojshëm që punëkërkuarit PAK kanë nevojë në aksesimin e plotë të portalit dhe të shërbimeve online që ofrohen.

7. A ka ndonjë plan apo iniciativë për të përmirësuar më tej aksesueshmërinë për këto grupe përdoruesish?

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka nisur procesin e rishikimit dhe vlerësimit të nevojave për përmirësim të mëtejshëm të portalit puna.gov.al me qëllim rritjen e aksesueshmërisë së tij nga personat me aftësi të kufizuara të shërbimeve online, trajnimin e tyre përmes kurseve që ofrohen falas për punëkërkuarit e papunë PAK të rregjistruar, si dhe mbështetjen e tyre përmes Programeve të Nxitjes së Punësimit. Këto të fundit ofrojnë mbështetje financiare të dedikuar për personat PAK për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës në përputhje me aftësinë e kufizuar të personit të punësuar përmes programit.

AKPA po prezanton pranë punëdhënësve aktivizimin e Fondit Social të Punësimit, i cili do të aktivizohet brenda vitit të ardhshëm dhe që synon sigurimin dhe administrimin e mekanizmave financiare për nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Fondi Social i Punësimit do të shoqërohet me një paketë shërbimesh dhe programesh punësimi dedikuar personave me aftësi të kufizuar për:

- financimin e programeve që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstrukcion dhe përshtatje të vendit të punës të personave me aftësi të kufizuara,
- financimin e programeve të riintegritimit social, mbështetjes për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara,

- për subvencionimin për rikonstrukcionin dhe përshtatjen e ambienteve të punësimit apo të institucioneve në të cilat ofrohen shërbimeve dhe trajnime, për të garantuar aksesueshmërinë dhe përshtatjen e arsyeshme për çdo person me aftësi të kufizuar.

Të tjera të dhëna

__ Nuk ka _____

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

Kërkoj që informacioni të më përcillet përmes email-it të dhënë

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/2020

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, [portalit pyetshtetin.al](http://portalit.pyetshtetin.al) apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit pyetshtetin.al
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.